



Kom.Dh.Shk.II.nr.912/2022

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Saranda Bogaj – Sheremeti, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve - shoqërive tregtare 1. Kompania e Sigurimeve “S...” sh.a, me seli ne Prishtinë, e përfaqësuar me autorizim nga A.G, 2. Kompania e Sigurimeve “D...” sh.a me seli ne Prishtinë, e përfaqësuar me autorizim nga N.D dhe 3. Kompania e Sigurimeve “I...” me seli ne Prishtinë, e përfaqësuar me autorizim nga B.D, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli ne Prishtinë, në çështjen juridike rimbursim i mjeteve financiare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala paditëse përmes te autorizuarve te tyre, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.37/20, të dt.06.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 01.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHEN si te bazuara ankesat paditësve 1. Kompania e Sigurimeve “S...” sh.a, me seli ne Prishtinë, 2. Kompania e Sigurimeve “D...” sh.a me seli ne Prishtinë dhe 3. Kompania e Sigurimeve “I...” me seli ne Prishtinë, ashtu që **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.37/20, të dt.06.07.2021, dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe rivendosje, Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës se Parë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor EK.nr.37/20 te datës 06.07.2021, ka vendosur me sa vijon:

I. Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike sipas padisë se paditësve 1. Kompania e Sigurimeve “S...” sh.a, me seli ne Prishtinë, 2. Kompania e Sigurimeve “D...” sh.a me seli ne Prishtinë dhe 3. Kompania e Sigurimeve “I...” me seli ne Prishtinë kundër te paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli ne Prishtinë.

II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lënda t’i dërgohet Departamentit të Përgjithshëm – Divizionit Civil, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si Departament me kompetencë lëndore për veprim te mëtutjeshëm.

Kundër këtij aktvendimi, paditësit kane paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit te gabuar të së drejtës materiale

dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktvendimi ankimor të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe nenin 195 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesat janë të themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit 1. Kompania e Sigurimeve “S...” sh.a, me seli ne Prishtinë, 2. Kompania e Sigurimeve “D...” sh.a me seli ne Prishtinë dhe 3. Kompania e Sigurimeve “I...” me seli ne Prishtinë, pranë Gjykatës Themelore Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, kane ushtruar padi, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli ne Prishtinë, ne emër te rimbursimit te mjeteve financiare. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të kësaj çështje juridike fillimisht ka vendosur ne mënyrë meritore me aktgjykim i cili eshte atakuar nga e paditura, e ku gjykata e shkalles se dyte duke vendosur sipas ankesës ka prishur aktgjykimin e shkalles e parë dhe ka kthyer çështjen ne rivendosje. Pas kthimit te çështjes ne rivendosje, gjykata e shkalles se pare ka marre aktvendim me te cili është shpalle jo kompetente per te vendosur ne këtë çështje juridike dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit ankimor duke u bazuar në nenin 16.1.1 të Ligjit për Gjykata dhe neni 19 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 paragrafi 2, pika (n) e LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë qëndron te jetë i themeltë pretendimi ankimor i paditësve 1. Kompania e Sigurimeve “S...” sh.a, me seli ne Prishtinë, 2. Kompania e Sigurimeve “D...” sh.a me seli ne Prishtinë dhe 3. Kompania e Sigurimeve “I...” me seli ne Prishtinë, për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar drejtë dhe konform nenit 19 të LPK-së, kur është shpallur jo kompetente ne pikëpamje lëndore për te vendosur ne këtë çështje juridike, e duke u thirrur se këtu e paditura nuk është shoqëri tregtare. Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktvendimit te atakuar ne kuptim te nenit 13 par.1 nën par.1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, ku shprehimisht përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për te gjykuar “kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe te huaja si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, ne lidhje me çështje te ndërsjella tregtare dhe çështje tjera ne mes tyre” .

Nga arsyet e cekura me lartë, Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kur ka vendosur se nuk është kompetente për te vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe neni 209 pika b) të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2019:241962
Datë: 26.07.2021
Numri i dokumentit: 02029690

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.800/2022, me datë 01.09.2022

Gjyqtari,

Faton Bajrami, d.v.